



Mus-e Kosova

UDHËZUES PËR SHFRYTËZIMIN E MUNDËSIVE TË OFRUARA NË PLATFORMËN SALTO-YOUTH



Ky udhëzues është përgatitur nga OJQ Mus-e Kosova me mbështetje të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit në Kosovë. Qëndrimet e reflektuara janë përgjegjësi e OJQ Mus-e Kosova dhe asesi e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.



UDHËZUES PËR SHFRYTËZIMIN E MUNDËSIVE TË OFRUARA NË PLATFORMËN SALTO-YOUTH

Ky udhëzues është përgatitur nga OJQ Mus-e Kosova për të lehtësuar informacionin për organizatat rinore rreth aplikimit të Erasmus+ në Kosovë. Të gjitha informatat janë grumbulluar, përpunuar dhe thjeshtëzuar duke shfrytëzuar informacionin zyrtar për Erasmus + me qëllim të lehtësimit për aplikime në programet Erasmus+ për organizatat rinore në Kosovë.

PËRMBAJTJA

5 Çfarë është SALTO-YOUTH?

6 Cilat janë qendrat e burimeve të SALTO-YOUTH dhe në çfarë fokusohen ato?

6 SALTO Inclusion & Diversity | SALTO Përfshirje & Diversitet (Belgjikë)

7 SALTO Participation & Information | SALTO Pjesëmarrja & Informacioni (Estoni)

7 SALTO Training and Cooperation | SALTO Trajnim dhe Bashkëpunim (Gjermani)

8 SALTO Eastern Europe and Caucasus | SALTO Evropa Lindore dhe Kaukazi (Poloni)

8 SALTO EuroMed (Francë)

9 SALTO South-East Europe | SALTO Evropa Juglindore (Slloveni)

9 European Solidarity Corps Resource Centre | Qendra Burimore e Korpusit
të Solidaritetit Evropian (Austri)

10 Si përditësoheni rreth mundësive që ofron SALTO-YOUTH?

12 Mjetet në kuadër të SALTO-YOUTH

12 European Training Calendar

14 Toolbox for Training

14 Atlas Partner Finding

14 Trainers Online for Youth

I. ÇFARË ËSHTË SALTO-YOUTH?

SALTO-YOUTH është akronimi për Support, Advanced Learning and Training Opportunities for Youth, gjegjësisht Mbështetje, Mësim i Avancuar dhe Mundësi Trajnimi për të Rinjtë. SALTO-YOUTH. Misioni i SALTO-YOUTH qëndron në përmirësimin e cilësisë dhe ndikimin e programeve të Bashkimit Evropian për rininë, respektivisht, Erasmus+ dhe programeve të Korpusit të Solidaritetit Evropian (European Solidarity Corpus), si dhe mbështetjen dhe zhvillimin e punës evropiane për të rinjtë. Si pjesë e strategjisë së Komisionit Evropian për trajnime, SALTO-YOUTH ofron burime të të mësuarit joformal për punonjësit e të rinjve dhe udhëheqësit rinorë, dhe njëkohësisht organizon trajnime dhe aktivitete për krijimin e kontakteve për të mbështetur organizatat dhe Agjencitë Kombëtare (National Agencies).



2. CILAT JANË QENDRAT E BURIMEVETË SALTO-YOUTH DHE NË ÇFARË FOKUSOHEN ATO?

SALTO-YOUTH si rrjet i burimeve të mësimi joformal, ofron shtatë qendra burimore që secila fokusohet në një temë ose rajon specifik, e që punojnë në fushat prioritare evropiane brenda sektorit të punës me të rinjtë. Përveç prioriteteve të tyre specifike, këto qendra burimore kanë edhe një numër të madh të bashkëpunimeve mes vete siç është zhvillimi i burimeve të trajnimit, dërgimi i buletinit të rregullt, ofrimi i Kalendarit Evropian të Trajnimeve (European Training Calendar) e të tjera.



Qendrat burimore janë:

SALTO Inclusion & Diversity | SALTO Përfshirje & Diversitet (Belgjikë)

<https://www.salto-youth.net/rc/inclusion/>


Fokusohet në trajnimin e të rinjve dhe punonjësve social për të filluar projekte gjithëpërfshirëse për të rinjtë me mundësi të kufizuara dhe t'i pajisin ata me shkathtësi që do t'iu mundësonin pastaj të merrshin me lloje të ndryshme të diversiteti. Puna që bënë kjo qendër burimore mbështet sidomos Komisionin Evropian në të menduarit strategjik për përfshirjen dhe diversitetin brenda programeve evropiane për të rinjtë dhe ndihmon në zbatimin e Strategjisë Evropiane të Përfshirjes dhe Diversitetit për Erasmus+ dhe Solidarity Corps.

Kjo qendër gjithashtu zhvillon materiale mbështetëse dhe promovon në mënyrë aktive qasje gjithëpërfshirëse në punën me të rinjtë në të gjithë Evropën. Për më detajisht, në menynë kryesore Resource Centers dhe pastaj në seksionin e Inclusion & Diversity mund të gjinden publikime, hulumtime, manuale dhe ide për frymëzime rreth përfshirjes dhe diversitetit, si dhe mundësi për financim apo trajnerë për projektet e juaja.

SALTO Participation & Information | SALTO Pjesëmarrja & Informacioni (Estoni)

<https://www.salto-youth.net/rc/participation/>

Inkurajon pjesëmarrjen aktive të të rinjve në procese të vendimarrjes si një pjesë integrale e qeverisjes demokratike, por gjithashtu eksploron trendet dhe mënyrat se si mund të bëhet kjo pjesëmarrje. Disa nga temat që ekspertiza dhe trajnimet e kësaj qendre burimore shtjellojnë për të trajnuar dhe mundësuar pjesëmarrjen e të rinjve janë shkrim-leximi mediatik, transformimi digjital dhe shkathhtësitë e komunikimit. Kjo qendër mbështet akterët e fushës rinore për të punuar në mënyrë strategjike për pjesëmarrjen dhe komunikimin e të rinjve në kuadër të programeve evropiane për të rinjtë. Gjithashtu, në mënyrë kryesore Resource Centers dhe pastaj në seksionin e Participation & Information mund të gjenden materiale trajnuese, informacione për evente dhe aktivitete të kësaj fushe, dhe detaje rreth çmimit SALTO që dhurohet për projektet frymëzuese dhe me ndikim në këtë fushë.



SALTO Training and Cooperation | SALTO Trajnim dhe Bashkëpunim (Gjermani)


<https://www.salto-youth.net/rc/training-and-cooperation/>

Kontribuon në cilësinë dhe zhvillimin e strategjive dhe aktiviteteve të trajnimit në fushën e rinisë dhe në njohjen e të mësuarit joformal për punën me të rinjtë në të gjithë Evropën. Me anë të Strategjisë Evropiane të Trajnimit, kjo qendër mbështet zhvillimin e kompetencave dhe ngritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe trajnerëve rinorë, si dhe të stafit të Agjencive Kombëtare (National Agencies). Gjegjësisht, mbështesin qasjet cilësore në bashkëpunimin transnacional, rrjetëzimin dhe mësimin e ndërsjellë midis Agjencive Kombëtare dhe partnerëve të ndryshëm. Si pjesë e punës së tyre është edhe implementimi i strategjisë Youthpass, që është instrument i njohjes për projektet e financuara nga programet e Erasmus+, Youth in Action dhe European Solidarity Corps. Për më tepër, tek menyja kryesore Resource Center e pastaj tek seksioni Training and Cooperation mund të gjeni më shumë informacione rreth thirrjeve për trajnimin e trajnerëve, njohjes së punës me të rinjtë dhe mësimin joformal, si dhe materiale të tjera relevante për fushën.

SALTO Eastern Europe and Caucasus | SALTO Evropa Lindore dhe Kaukazi (Poloni)

<https://www.salto-youth.net/rc/eeca/>

Qëllimi i kësaj qendre burimore është të rrisë dukshmërinë dhe ndërgjegjësimin e programeve të Erasmus+ Youth dhe European Solidarity në Armeni, Azerbajxhan, Bjellorusi, Gjeorgji, Moldavi, Rusi dhe Ukrainë. Kjo qendër lehtëson rrjetëzimin ndërmjet organizatave rinore të këtyre vendeve dhe shteteve të tjera evropiane. Qëllimi kryesor është që të rrisin cilësinë e projekteve rinore përmes kurseve të trajnimit dhe publikimeve. Tek menyja kryesore Resource Centers dhe pastaj seksioni i Eastern Europe and Caucasus, mund të gjenden më shumë informacione mbi mundësitë e bashkëpunimit, trajnimeve, seminareve. Kjo qendër është gjithashtu përgjegjëse për Etiketën e Cilësisë, një proces i akreditimit të organizatave të këtij rajoni që dëshirojnë të marrin pjesë në programet e European Solidarity Corps.



SALTO EuroMed (Francë)


<https://www.salto-youth.net/rc/euromed/>

Synon të rrisë bashkëpunimin në punën me të rinjtë midis organizatave në skajet e kundërta të Mesdheut brenda programeve Erasmus+ dhe European Solidarity Corps. Kjo qendër organizon kurse dhe trajnime kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe prodhon dhe shpërndan mjete dhe botime edukative. Edhe kjo qendër është përgjegjëse për Etiketën e Cilësisë, si dhe trajnimin e vullnetarëve dhe organizatave në rajonin e Mesdheut Jugor. Rreth kësaj qendre, mjeteve dhe materialeve që i ofron, mund të kuptohet më shumë tek menyja kryesore Resource Centers dhe pastaj seksioni EuroMed.

<https://www.salto-youth.net/rc/see/>

Qëllimi i kësaj qendre burimore është të mbështesë pjesëmarrjen e vendeve partnere të Ballkanit Perëndimor (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi dhe Serbia) në kuadër të Programit Erasmus+ dhe European Solidarity Corps. Kjo qendër mundohet të frymëzojnë veprim përmes trajnimeve, aktiviteteve për gjetjen e partnerëve, mjeteve dhe burimeve të tjera mbështetëse. Synimi kryesor i tyre është që të kontribuojnë në punën për të rinjtë dhe zhvillimin e politikave rinore në Ballkanin Perëndimor, në bashkëpunim me akterë të tjerë dhe me ndihmën e trajnerëve, ekspertëve të Etiketës së Cilësisë dhe pikave të kontaktit të vendosura në vendet partnere të programeve në rajon.

Në menynë kryesore Resource Center e pastaj seksionin South-East Europe, mund të gjenden informacione rreth pikave të kontaktit, bashkëpunimit në Ballkanin Perëndimor, materialeve të ofruara, dhe thirrjeve të hapura për të mbështetur aktivitete.



European Solidarity Corps Resource Centre | Qendra Burimore e Korpusit të Solidaritetit Evropian (Austri)

<https://www.salto-youth.net/rc/solidarity/>

Mbështet Agjencitë Nacionale dhe organizatat në fushën rinore e më gjerë me zbatimin e programit të European Solidarity Corps. Misioni i tyre është të eksplorojnë potencialin e solidaritetit si një vlerë thelbësore në shoqëritë evropiane dhe të promovojnë përdorimin e Korpusit Evropian të Solidaritetit si një mjet për të kuptuar dhe jetuar solidaritetin. Kjo qendër koordinon aktivitetet e rrjetëzimit, trajnimet, seminarët dhe ngjarjet që mbështesin zbatimin cilësor të programit dhe maksimizojnë ndikimin e tij. Duke bërë këtë, kontribuohet në ndërtimin e një komuniteti të organizatave të Korpusit të Solidaritetit Evropian. Më shumë informata rreth këtyre komuniteteve të organizatave dhe mundësive që ofrohen përmes tyre mund të gjenden tek menyja kryesore Resource Center e pastaj seksioni Solidarity Corps.

SI PËRDITËSOHENI RRETH MUNDËSIVE QË OFRON SALTO-YOUTH?

Mënyra më e mirë për të hulumtuar çfarëdo mundësie trajnimi dhe rrejtëzimi për ju apo organizatën tuaj është të regjistroheni/hapni llogari në uebfaqën e SALTO-YOUTH (<https://www.salto-youth.net/mysalto/signup/>).

MySALTO More possibilities, more Europe



Not registered yet?
Register here - you will receive a password in your email

First name

Emri

Last name

Mbiemri

Gender

- please select -

Postal address to contact me

Adresa e kontaktit

1

Country

KOSOVO * UN RESOLUTION

Primary phone number to contact me

Numri i kontaktit

Primary email to contact me

Adresa elektronike

Organisation I am representing

Organizata

Organisation address

Adresa e organizates qe perfaqesonit

2

I accept the [terms of privacy](#)

Mandatory fields are printed in bold.

Register

or [Cancel](#)

Pasi t'i keni plotësuar rubrikat e kërkuara me të dhënat përkatëse, ju do të pranoni një e-mail me një fjalëkalim të gjeneruar nga vet uebfaqja. Fjalëkalimin mund t'a ndryshoni pastaj në operacionet e llogarisë tuaj.

Pasi të ktheheni tek uebfaqja dhe të kyqeni me detajet e dërguara në e-mail, ju do të mund të keni mundësi të hulumtoni trajnimet aktuale si dhe të aplikoni për to. Nga menyja kryesore Tools, duhet të zgjedhni opsionin e European Training Calendar dhe pastaj opsionin në anën e djathtë lart Find Trainings (<https://www.salto-youth.net/tools/european-training-calendar/browse/>). Ky mjet do të shpjegohet më detajisht mëposhtë.

The screenshot displays the SALTO-YOUTH website interface. At the top, there is a navigation bar with the SALTO logo and several menu items: 'About SALTO' (Why? What? Where? When? Who?), 'Resource Centres' (Our activities and resources for you), 'Tools' (For European youth work and training), and 'MySALTO' (Login to your personal SALTO dashboard). Below the navigation bar, a central banner reads 'The SALTO-YOUTH Resource Centre promote and support youth work, tools and state-of-art... trainings,'. A vertical menu on the right side of the banner lists various tools: 'European Training Calendar', 'Atlas Partner-finding', 'Toolbox for Training', 'Trainers Online for Youth', 'Call for Trainers', 'NEW QualityMobility.app', 'HOP online learning', 'SALTO Publications', 'SALTO & Evaluation', 'MOOC on Erasmus+', and 'MOOC European Solidarity Corps'. The main content area features a section for the 'European Training Calendar' with a featured training course titled 'ATOQ Advanced Training On Netherlands' taking place from 20-25 March 2022 in Netherlands (Soest). A description of the ATOQ training course is provided, stating it is aimed at youth workers who want to raise the quality of their youth exchanges. Below this, there are links for 'Head over to the Training Calendar', 'Trainers Online for Youth' (Find a trainer for your activity - or list yourself), and 'Toolbox' (Methods to inspire your training - or share your tools).

Përveç hapjes së llogarisë, ju gjithashtu mund të abonoheni në buletin e lajmeve që iu dërgohet në emailin tuaj në baza mujore nga SALTO-YOUTH (<https://www.salto-youth.net/about/neesletter/>). Abonimi në buletin mujor ju mban të përditësuar me të gjitha mjetet, botimet e dobishme, ngjarjet dhe lajmet nga të gjitha Qendrat Burimore të SALTO-YOUTH dhe partnerët e tyre.




MJETET NË KUADËR TË SALTO-YOUTH

Uebfaqja e SALTO-YOUTH ka në funksion shumë mjete (tools) që ofrojnë mundësitë për trajnim dhe rrjetëzim, ashtu siç është përshkuar mësipër:

EUROPEAN TRAINING CALENDAR

Këtu do të gjeni trajnime dhe seminare të drejtuara nga SALTO, qendrat burimore, Agjencitë Kombëtare (National Agencies) të Erasmus+ dhe OJQ-të në fushën e rinisë. Ky mjet ofron mundësi për punonjësitë në fushën e rinisë, liderët e rinisë, mësimdhënësit, por njëkohësisht mundëson edhe promovimin e trajnimeve apo seminareve të organizatës tuaj në fushën e rinisë.

Pasi të keni hapur llogarinë, do të mund të vendosni kritere në kërkimin e trajnimeve/aktiviteteve shembull: trajnime të ofruara për pjesëmarrës nga Kosova, të mbajtura në një vend të caktuar, koha kur do të mbahet aktiviteti e të ngjashme.

	About SALTO Why? What? Where? When? Who?	Resource Centres Our activities and resources for you	Tools For European youth work and training	MySALTO Login to your personal SALTO dashboard
--	---	--	---	---

European Training Calendar

[Find training offers](#)

[Your applications](#)

[Manage your training offers](#)

[Help](#)

The European Training Calendar

Everything at a glance: training within the Erasmus+ Youth in Action Programme, European Solidarity Corps and beyond!

Are you curious about what Europe has to offer in training activities in the field of youth and non-formal education? Search this online calendar for interesting international training and use it for promoting your own training offers!

The main focus of the European Training Calendar is the Erasmus+ Youth in Action and European Solidarity Corps programmes. All training activities in the Calendar should be European (or international), not-for-profit and directed to youth workers wishing to develop their competences to further work with and for young people, to share experiences and, on occasion, to make contacts for common future projects. Besides, the calendar can also publish calls for projects in which youth workers will meet other target groups such as youth policy makers, adult learning organisers, among others, in order to learn from each other.

All new training offers in your inbox

Be the first to know about new training offers with our [e-mail notifications](#).

We have 31 upcoming trainings listed.

Seminar

Youth@Work Online Seminar: Employment and entrepreneurship of young people with fewer opportunities - with the emphasis on women's entrepreneurship

23-24 November 2021 | online, Poland

E-learning

Quality of Youth Work

25 November 2021 | Online, Belgium - FL

Seminar

Youth@Work Seminar: Future Of Work For Young People

13-17 December 2021 | Antalya, Turkey

Seminar

We found 10 training offers matching your search!

Filter your results

Search by keyword

Activity organised by
- please select -

[Add](#)

Activity funded by Youth in Action

Country where the activity will take place
- please select -

For participants from
KOSOVO * UN RESOLUTION

Activity type

- Study Visit [i](#)
- Partnership-building Activity [i](#)
- Seminar [i](#)
- Training Course [i](#)
- E-learning [i](#)
- Conference - Symposium - Forum [i](#)

Sort by Application deadline

Seminar

Youth@Work Online Seminar: Employment and entrepreneurship of young people with fewer opportunities - with the emphasis on women's entrepreneurship

23-24 November 2021
online, Poland

Youth@Work Seminar will inspire you to exchange good practices, contribute to networking and cooperation between organizations, show the possibilities of designing your own activities using the Erasmus + European Solidarity Corps Programs.

Application deadline (24h UTC):
15 November 2021


This activity is for participants from
Erasmus+: Youth in Action Programme countries [i](#), Partner Countries Neighbouring the EU [i](#)

TOOLBOX FOR TRAINING

Përmban mjete, metoda, burime dhe ide aktivitete për trajnim në fushën e punës me të rinjtë. Në të njëjtën kohë, ofron edhe mundësinë e shpërndarjes së materialeve të organizatës tuaj në lidhje me fushën e rinisë. Toolbox for Training ofron një listë me mbi 2000 mjete, të qasshme për përdoruesit e platformës.

OTLAS PARTNER FINDING

Ju vë në kontakt me mijëra projekte rinore, kështu që ju mund të ndërtoni partneritete të forta dhe të aplikoni për Erasmus+. Gjithçka që duhet të bëni është të përshkruani organizatën tuaj dhe idenë e projektit për të gjetur partnerë, ose të shfletoni nëpër bazën e të dhënave për mundësi bashkëpunimi me partnerët apo në projektet që do të dëshironit të bashkoheni. Të listuara në platformë janë afër 9000 projekte ndërkombëtare dhe pothuajse 14000 organizata dhe grupe joformale.



TRAINERS ONLINE FOR YOUTH

Është lista me mbi 500 trajnerë ndërkombëtar, të cilët mund të ofrojnë përvojën e tyre në aktivitete apo trajnimet e juaja. Gjithashtu, këtu mund listoni veten në bazën e të dhënave si trajner për të rinjtë për të ndarë ekspertizën tuaj në projekte apo aktivitete që organizohen në nivel ndërkombëtar.

